



Në bazë të nenit 110 dhe 141 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta zyrtare 82/18 dhe 178/21), Vendimit për akreditim nr. 18-12190/3 të datës 13.09.2021 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RMV-së, Rregullores për mënyrën e ndjekjes së mësimit, dhënies së provimeve për përgatitjen pedagogjike-psikologjike dhe metodike, si dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë (Gazeta zyrtare e RMV-s nr. 241/2020 dhe 11/2021) dhe Vendimi nr. 02-4410/1 i Këshillit të Rektoratit më 09.12.2021, Universiteti i Tetovës shpall:

## KONKURS

për regjistrimin e kandidatëve për **përgatitjen pedagogjike - psikologjike dhe metodike** në Fakultetin Pedagogjik në Tetovë

### I. Aplikimi, regjistrimi dhe të dhënat për studimet

Të drejtë për regjistrim kanë të gjithë kandidatët të cilët kanë kryer studime akademike përkatëse të ciklit të parë me 240 ECTS të akumuluar, të cilët nuk janë drejtime arsimore. Me regjistrimin e studimeve kandidati fiton statusin e kandidatit për marrjen e kualifikimit plotësues, përkatësisht përgatitje pedagogjike - psikologjike dhe metodike. Ky cikël i studimeve organizohet në kohëzgjatje prej 1 (një) semestri, sipas kriterëve të Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS). Me përfundimin e këtyre studimeve, kandidati fiton **30 ECTS** kredi. Kandidatët e regjistruar për rikualifikim pedagogjik - psikologjik dhe metodike përpara sjelljes së Rregullores për mënyrën e ndjekjes së mësimit, dhënies së provimeve për përgatitje pedagogjike - psikologjike dhe metodike, si dhe mënyrën e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 56, e datës 27 mars 2014), mund t'i kryejnë studimet me dhënie e tri provimeve të parapara (pedagogji, psikologji dhe metodikë), rikualifikimi në dy lëndë zgjedhore nga programi i ri studimor për përgatitje pedagogjike - psikologjike dhe metodike dhe realizim të mësimit praktik në kohëzgjatje prej 45-ditësh në shkollë të mesme/përkatësisht shkollë fillore. Fakulteti Pedagogjik do të sjellë vendim për numrin minimal të nevojshëm për fillimin e procesit në këtë cikël studimi.

### II. Realizimi i studimeve

Përgatitja pedagogjike - psikologjike dhe metodike do të realizohet në lëndët si më poshtë:

Nr.	Lënda	ECTS	Statusi
1	Pedagogji	5	Obligative
2	Psikologji	5	Obligative
3	Metodikë	5	Obligative
4	Praktika pedagogjike (45 ditë)	7	Obligative
5	Dokimologjia shkollore	4	Zgjedhore
6	Organizimi i shkollës	4	Zgjedhore
7	Etika në arsim	4	Zgjedhore
8	Metodika e punës edukative	4	Zgjedhore
9	Komunikimi pedagogjik	4	Zgjedhore
10	Arsimimi ndërkulturor dhe shumëkulturor	4	Zgjedhore
11	Arsimi inkluziv	4	Zgjedhore

Kandidati zgjedh 2 lëndë zgjedhore.

### III. Afati dhe dokumentacioni

<b>Aplikimi</b> (online në <a href="http://www.unite.edu.mk/apply">http://www.unite.edu.mk/apply</a> dhe në Fakultetin Pedagogjik)	<b>25.01-09.02.2022</b>
<b>Vendimi për pranim</b> (do të shpallet në Fakultetin Pedagogjik)	<b>14.02.2022</b>
<b>Regjistrimi i kandidatëve të pranuar</b>	<b>15-18.02.2022</b>
<i>Kandidatët që nuk bëjnë regjistrim do të humbin statusin e pranimit</i>	

**Dokumentet për aplikim dhe fletëpagesa gjatë aplikimit online bashkangjiten (attach) të skenuara ose fotografi brenda formularit:**

1. Diplomë e noterizuar për përfundimin e studimeve
2. Certifikatë të lindjes
3. Certifikatë të nënshtësisë
4. Vërtetim për marrëdhënie pune
- a) Vërtetim për pagesat: **1050 denarë** në xhironlogarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative.

Nëse kandidati është pranuar, gjatë regjistrimit duhet të dorëzojë në shërbimin administrativ të Fakultetit Pedagogjik:

1. Tri fotografi (6 x 9 dhe një – 4 x 5 c. m.)
2. Fletëregjistrim (merret në fakultet)
3. Vërtetim për pagesat:
- a. 250 euro: për regjistrimin e studimeve

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhironlogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

- Në emri i marrësit (назив на примачот) - Universiteti i Tetovës,
- Në „banka e marrësit“ (банка на примач) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Në „logaria“ (сметка) – 100000000063095,
- Në „shuma“ (износ) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhen,
- Në „logaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues“ (сметка на буџетски корисник – единка корисник) – 1600160054 788 10;
- në „shifra dhe programi i të hyrave“ (приходна шифра и програма) – 723019 43, ndërsa në „mënyra“ (начин) – 2;

Konkursi do të shpallet në faqen e internetit: <http://www.unite.edu.mk>